



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 28

Tiranë – E hënë, 22 korrik 2019

PËRMBAJTJA

Faqe

Kërkesë e Ministrisë së
Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale, nr. 3724,
datë 18.7.2019

Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Forcimi i kapacitetit zbatues të njësive të qeverisjes lokale, drejtorive rajonale dhe SHSSH qendrore për koordinimin e shërbimeve sociale (menaxhimi i rasteve) për personat me aftësi të kufizuara” No. SAMP/CS/CQ/04-2019.....

3

**KËRKESË****Nr. 3724, datë 18.7.2019**

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“FORCIMI I KAPACITETIT ZBATUES
TË NJËSIVE TË QEVERISJES LOKALE,
DREJTORIVE RAJONALE DHE SHSSH
QENDRORE PËR KOORDINIMIN E
SHËRBIMEVE SOCIALE (MENAXHIMI I
RASTEVE) PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA”**

Ref. no. SAMP/CS/CQ/04-2019**Tiranë 15.7.2019**

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)

Hua No.: 8841- AL

Nr. i identifikimit të Projektit. P162079

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim shtesë nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (“Shërbim”) së kërkuar është “Asistencë teknike

për të kryer një vlerësim të gjendjes së invalidëve të punës”.

Shërbimi i konsulencës (“Shërbimet”) përfshin zhvillimin e një modeli (procedurat, dokumentimin, trajnimin etj.) të menaxhimit të rastit në mbështetje të koordinimit të shërbimeve për përfituesit e përfitimeve të aftësisë së kufizuar për Shërbimet Sociale të Bashkisë Tiranë. Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga një ekspert social, një ekspert mjekësor dhe një ekspert ligjor. Konsulenti pritët të fillojë shërbimin në shtator 2019 dhe vazhdon deri në nëntor 2019.

Termat e detajuara të Referencës (TOR) për këtë shërbim gjenden në faqen e internetit si vijon: <http://www.shendetesia.gov.al/kerkesa-per-shprehje-interesi/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjithë konsulentët legjitimë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion ku të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

1.	Biznesi kryesor dhe vitet në biznes	20 pikë
2.	Experienca specifike e firmës në fushën e shërbimit	40 pikë
3.	Organizimi teknik dhe menaxherial i firmës	10 pikë
4.	Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tre viteve të fundit	30 pikë
	Total	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në Seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të “Rregullave të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI”, të datës Korrik 2016 (“Rregullat e Prokurimit”).

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre por duhet të tregojnë qartë nëse shoqata është në formën e një “joint venture” apo në formën e nën-kontraktimit. Në rastin e një “joint venture”, të gjithë partnerët në “joint venture” do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të tërë kontratën, në rast se përzgjidhet.

Një konsulent do të zgjidhet në përputhje me metodën e “Përzgjedhje Bazuar në Kualifikimet e Konsulentit – CQ”, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregullat e Prokurimit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:30 (e Henë deri të Enjten) dhe 08:00-14:00 të Premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi, ose me e-mail) deri në **30 Korrik 2019**.

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës
Sociale (samp)
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale – Kati I
Rr: “Kavajës”, Nr.53, AL - 1001, Tirana,
ALBANIA**

**Në vemendje të: Znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019